

IV.Ek.C.nr.100/18

GJYKAKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE EKONOMIKE me gjyqtarin Murat Paçarada, duke vendosur në çështjen kontestuese sipas padisë së paditëses “MBPZHR” Agjencia Pyjore e Kosovës me seli në Prishtinë, kundër të paditurit Kompania e Sigurimeve [”S...”] me seli në Prishtinë, për shkak të borxhit , vlera e kontestit në shumën prej 28.716.00 € ,pas mbajtjes së seancës përgatitore, me dt.04.03.2019, harton këtë këtë;

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET, se paditësja ‘MBPZHR’ Agjencia Pyjore e Kosovës me seli në Prishtinë, e ka tërhequr padinë e ushtruar me datën 23.02.2018, kundër të paditurit, Kompania e Sigurimeve [“S...”] me seli në Prishtinë në këtë çështje juridike.

Secila pale i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m i

Paditësja “MBZHR” Agjencia Pyjore e Kosovës, me seli në Prishtinë me dt.23.02.2019, ka ushtruar padi kundër të paditurit, Kompania e sigurimeve [“S...”] me seli në Prishtinë, për shkak të kthimit të borxhit, për shkak të moszbatimit të konfiskimit të Sigurisë për rikultivimit në vlerën prej 28.716.00€.

Gjykata me datën 24.01.2019 e ka caktuar seancën përgatitore, në të cilën palët ndërgjyqëse kanë qenë të ftuara në mënyrë të rregullt, mirëpo pala paditëse nuk ju ka përgjigjur ftesës dhe si dhe nuk e ka arsyetuar mungesën e saj .

Pala e padituri në këtë seancë i ka propozuar gjykatës që te marr aktvendim, më te cilën do te konsiderohet se padia e paditësit do te konsiderohet e tërhequr.

Gjykata, ka e ka aprovuar propozimin e palës së paditur, komfor nenit 409.1, të LPK-së e ka konsideruar se padia e paditësit është Tërhequr, andaj u vendos si në diapozitiv.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës është marrë konform nenit 450 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE EKONOMIK

IV.EK.C.nr. 100/18, dt.04.03.2019

**Gjyqtari,
Murat Paçarada**

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktvendimi në kuptim të nenit 261.4 të LPK-së nuk është e lejuar ankesa .